

SHPRESA ISMAJLI

VËZHGIME LEKSIKO - SEMANTIKE NË TREVËN E LLAPIT

Siç është e ditur, prurjet nga dialektet vazhdimisht e kanë pasuruar gjuhën standarde me njësi të shumta leksikore, të panjohura ose pak të njohura më parë, e gjithashtu edhe me mjetet me të cilat janë formuar. Edhe kur këto mjete fjalëformuese i ka gjuha letrare, ato përsëri i sjellin pasurim asaj, sepse zgjerojnë vargjet fjalëformuese, e në tërësi prejardhjen fjalëformuese dhe semantikën e saj.¹

Duke qenë në një zonë periferike të Kosovës, popullsia e trevës së Llapit, e cila është edhe vendlindja jonë, ka ruajtur shumë njësi leksikore, frazeologjizma e shprehje të ngurtësuara të fjalëve, të vlefshme për studime leksikore, dialektologjike, për historinë e gjuhës etj. Pra, lënda leksikore e kësaj treve na del mjaft e pasur dhe me veçori të shumta. Ligjërimi popullor i përditshëm i zonës së marrë në shqyrtim sjell njësi të reja leksikore, kuptime të reja ose nuanca të reja kuptimore nga ato që përfshihen në fjalorët shpjegues të shqipes. Këto njësi leksikore shënojnë: nocione e kuptime konkrete që lidhen me jetën familjare, me shtëpinë e kuzhinën, me mjeshtëritë e me mjetet e punës, me bujqësinë e blegtorinë, me shtazërinë e me bimësinë; nocione e kuptime abstrakte nga bota shpirtërore dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore, nga fusha e etnokulturës, mendësitë e zakonet; njësi leksikore karakterizuese për njerëz; si dhe njësi leksikore me kuptime të figurshme e me ngjyime të theksuara emocionale etj.

Në fondin leksikor të kësaj zone ndeshim njësi leksikore nga të gjithë tipat leksiko-gramatikorë: emërorë, mbiemërorë, foljorë, ndajfoljorë etj., shumicën e të cilave nuk i gjejmë në fjalorët shpjegues të shqipes, apo na dalin me kuptime të reja leksikore ose me nuanca të reja kuptimore nga ato të pasqyruara në fjalorë. Për nga denduria e përdorimit njësitë leksikore emërtuese janë më të shumta, ato foljore janë më të pakta.

Nga kjo lëndë leksikore kemi veçuar fjalët: *beg* – misër me kokrra të kuqe; *bardhditë* (ditë me fat të mirë); *dokë* – bukuri, të qenët i bukur; *dyzen* – grim; *hjekë* – vuajtje, mundime; *hinedelca* – mysafirët që vijnë

¹ H. Shehu, *Studime për leksikon dhe leksikografinë e sotme shqipe*, Tiranë, 2015, f. 27.

shpesh e nuk rrinë shumë; *fshisatore* – gruaja e cila fshin shtëpinë; *furfullak* – frikë e madhe; *gaztore* – që është tërë gaz, e qeshur; *greki* – femër shtathedhur; *gropacak* – grindavec, ngatërrestar; *guriç* – i fortë si guri; *gji* – pjesa nën vete (midis këmbëve) e të mbathurave ose e pantallonave; *kojs* – zhvatës; *kohanik* – i shtyrë në moshë; *kërkesçe* – shëtisë, bredhëse; *kosime* – koha e të kositurit; *kryedite* – një pjesë të ditës, disa orë; *nërlig* – dhëmb i dalë nën ose mbi dhëmbin tjetër; *lugabreg* – vend jo i rrafshët; *marime* – ushqime të gatuar, gatesa; *mledhi* – festë (edhe *mbledhim*); *prashime* – koha e të prashiturit; *rreshke* – korja e skuqur e bukës a gatimeve tjera; *sikushi* – zemërmirë, fisnike; *sybutë* – që i vjen zor t’ia thotë tjetrit gabimin në sy; *zemërok* – trim, që ka zemër të madhe; *zezditë* – kob, fatkeqësi etj.

Kjo trevë është e pasur edhe me lëndë etnografike, si: *bullë* - krushkë (ndërsa për gjininë mashkullore përdoret *krushk*), *bullan* – djalë i vogël i familjes së dhëndrit që shkon me bulla për të marrë nusen; *palohe* – qëndroj në këmbë në ditën e dasmës, nusëroj; *pame*, *-ja* – ceremonia që mbahet për të vdekurin, e cila tash së voni bëhet kryesisht tri ditë; *pamë*, *-t* (të) as.- shkuarja e gruas në gjini; *telaki* – vajza që e stoliste nusen e re kur martohej, bullë etj.

Numri më i madh i foljeve që gjejmë në këtë trevë janë të formuara nga tema fjalësh të njohura me anë të prapashitesës *-o(j)*, e cila përbën tipin më prodhimtar e më aktiv: *çyshkoj* – skutëloj (nga *qysh*); *drenoj* – mbyll me dry (dry); *azgin* – trimëroj (nga *azgin*), *cullakohem* - vishem hollë (nga *cullak*), *çeftohem* (*qefleisem*) – gëzohem, kënaqem (nga *qef*); *çeskinohem* – trimërohem (nga *qesqin*); *dejem* – hollohem (nga *dejë*), *dërrasoj* – vë dërrasat në tavan etj. (nga *dërrasë*); *eksikoj* – cenoj (nga *eksiq*); *fiçiroj* – mendoj (nga *fiqir*), *futoj* – ia nxij jetën diku (nga *futë*); *gazepoj* – mundoj (nga *gazep*); *gazit* – e bëj një punë keq (nga *gaz*); *gojoj* – montoj (nga *gojë*); *hatërohem* – më mbetet hatri (nga *hatër*); *krahoj* – skajoj (nga *krah*); *kafshatoj* – ha kohë pas kohe nga pak, ha nga dy-tri kafshata (nga *kafshatë*); *klapitem* – dremitem (nga *klapi*); *kurthoj* (edhe *kurthuroj*) – ngatërroj, pështjeltoj (nga *kurthë*); *javashit* – ngadalësoj (nga *javash*); *kusuritem* – shlyej borxhin që kam ndaj diku (nga *kusur*); *paçefem* – sëmurem (nga *paqejf*); *pykoj* – fut pykën (nga *pykë*); *rriskoj* – e mbush buzë më buzë (nga *rrësk*); *shishmoj* – e bëj të shijshëm (nga *shije*); *shtar* – e bëj shumë të kripur një ushqim (nga shtarë “i kripur”); *thuproj* – thur me thupra (nga *thupër*) etj.

Në ligjërimin e kësaj treve ndajfoljet na dalin të shumta dhe me larmi kuptimore. Të tilla janë: *asgja* – kot, pa ndonjë shkak a arsye; *averim* – me

shpejtësi, me nxitim; *brinjaz* – keqas, me marrëdhënie jo të mira; *çkeptaz* – shpërndaras, largas; *ngjim* – radhazi; *rrumaz* – herë mirë e herë keq; *trubullueshëm* – plogët etj. Me mjaft interes na duken edhe disa formime të përngjitura ndajfoljore, të cilat kanë përdorim të dendur në trevën tonë, si: *briëmbri*, *frymënyft*, *fikpërpjetë*, *herdokur*, *herdokurdo*, *kamëmaskame*, *kryepërkrye*, *kryenveti*, *nkamendorë*, *ngjitangjit*, *nisesos*, *pikepesë*, *vaktepavakt etj.*; si dhe ndajfoljet e përngjitura të tipit *kryedite*, *kryeveni*, *katërlamsh*, *miradashtaz etj.*, të cilat në gjendjen e sotme të gjuhës mund të merren si fjalë të përbëra.

Leksiku me ngjyrim emocionues.

Ngjyrimi emocionues pozitiv përfshin njësi të ndryshme leksikore: *burrnore* – burrëreshë, *çallshnik* – guximtar, *gjallnik / gjallonore* – punëtor, *katanë* – grua e fuqishme, *prehacak* – mendjemprehtë, *syret* – fig. shumë e bukur, *shpatë* – fig. e shkathët, *rrotel* – burrë i mençur e guximtar etj.; emrat *dajok*, *halloke*, *mixhok* – përdoren me nuanca përkëdhelie etj.

Me konotacione negative është një numër më i madh njësisht: *cofëtinë* – fig. keq. përdoret figurativisht për njerëz të ngathët; *çykë* – fig. kokëfortë; *çokat* – fig. ngacmoj a thumboj me fjalë; *gjysë* – fig. gjysmak nga mendja; *kaçep* – fig. grindavec; *lepak* – fig. keq. njeriu që të qepet pas; *i untë* – fig. i pangopur; *tarakeshë* – fig. përç. grua që flet shumë etj.

Me nuanca të theksura ekspresive (kryesisht keqësuese) përdoren edhe një numër kompozitash: *ballashyt* (kokëmadh), *bukëpërmyst* (mosmirënjohës), *buzëçerëp* (që i ka buzët e nxira), *çehreranë* (fytyrëngrysur, që mbahet rëndë e me të madh), *filzi* (dashakeq), *gojëçkyme* (gojëleshuar), *haezi* (që s'ka oreks), *hallligë* (shëndetlig), *hisesost* (farëshuar), *krahthamë* (fig. i vetëm, i pakrah), *kryengritë* (kokëfortë), *kryeshinik* (kryemadh), *kryezi* (flokëzi), *kryeçpuem* (fig. që nuk merr vesh, kokëtrashë), *sybutë* (fig. që i vjen zor t'ia thotë tjetrit gabimin në sy), *syligë* (fig. sykeq), *syfortë* (fig. i paturp, i pacipë), *syfrytë* (që ka sy të fryrë, me sy të qitur jashtë), *syhapt* (që ka sy të mëdhenj), *sykrist* (fig. i pacipë, që s'ka pikë turpi), *syuntë* (fig. i pangopur), *sykapsoll* (që i ka sytë e hapur e të dalë jashtë) etj.

Në të folmen tonë përdoren edhe disa fjalë të përbëra bisemantike, të cilat përveç kuptimit cilësor-pronësor, shprehin një dëshirë, një cilësi që dëshirohet ta kenë qeniet a sendet që ato emërtojnë ose të cilave u referohen, si: *farësost*, *gojëçkyme*, *gjakshkymt*, *hisesost*, *nafakzezë* etj. Këto fjalë shënojnë një qenie jo nëpërmjet të një tipari që ajo ka, por të një tipari

që dëshirohet ta ketë², të cilët në kontekste e situata të caktuara zbërthehen “ai që iu sostë fara, ai që e pastë farën të shuar”. Te kompozitat e tilla bisemantike, kuptimi dëshiror ka lindur zakonisht mbi bazën e ‘zgjerimit’ të kuptimit cilësor-pronësor, nëpërmjet nëmës a urimit, duke e projektuar zotërimin e “pronës”, të cilësisë nga plani real i së shkuarës e i së tashmes në planin potencial të së ardhmes.³

Në trevën tonë, me ngjyrimë të ndryshme negative përdoren mjaft dendur edhe foljet, si: *çaravesh* (keq. shtrembëroj fytyrën në shenjë mospërfilljeje, ironie apo edhe nga ndonjë shqetësim), *çokat* (fig. keq. ngacmoj a thumboj me fjalë), *çprush* (fig. keq. përpiqem të nxjerr diçka në shesh), *çprrallohem* (keq. bëhem i paturp), *çupurit* (fig. keq. gjurmon tinëz gjësendet e dikujt), *grepacoj* (keq. ther me fjalë, ngacmoj); *gullmoj* (keq. lakmoj së tepërmi, kam dëshirë të madhe për të pasur diçka), *hajkatem* (keq. sorollatem), *idhtoj* (fig. keq. zemëroj, mërzit), *kallafut* (keq. bëj punë shkel e shko, i jap një kalla, me këtë kuptim edhe *kollovit*), *kaliroj* (fig. keq. endem kot poshtë e lart, bredh), *koptis* (keq. shfryj dufin, shkarkoj zemërimin mbi dikë, s’i lë gjë pa i thënë), *kulubishtohem* (keq. shoqërohem me njerëz të këqij, shkoj e vij shpesh me ta), *lepuroj* (fig. keq. hulumtoj, gjurmoj andej e këndej), *loçkoj* (fig. keq. prish krejt), *lyhem* (fig. keq. qepem pas), *mrizoj* (fig. keq. rri kot), *ngërrzhat* (keq. e josh në punë të këqija, e tërheq), *përbishtohem* (keq. shkoj e vi shpesh), *përshosh* (keq. shpërfill), *sharroj* (fig. gabohem rëndë), *shishat* (keq. përçm. përfill), *shtramoj* (keq. imitoj të folurit, lëvizjet, veprimet e dikujt), *tharb* (fig. keq. i kundërvihem ashpër); *therrcat* (keq. thumboj me fjalë), *xekrrohem* (keq. nervozohem, acarohem), *vajvitem* (keq. endem poshtë e lart) etj. Po kështu edhe ndajfoljet përdoren me konotacione të ndryshme pozitive e negative: *brinjaz* (fig. keq. herë mirë e herë keq), *çkoçë* (fig. keq. gënjej sy ndër sy); *gërrditshëm* (keq. neveritshëm), *hollë* (fig. me skamje, me varfëri, *përhunsh* (fig. përdoret në rrethanat kur dikush ta bën një të mirë e ta përmend gjithnjë, kërkon t’i jesh mirënjohës përherë), *pingul* (fig. troç, hapur) etj.

Ngjyrimi emocionues, siç e dimë, arrihet edhe me anë prapashtesash. Shumica e këtyre formimeve në trevën tonë janë emërtime për njerëzit (kryesisht me ngjyrimë emocionale negative) të formuara prapashtesat: -*an*, -*ak*, -*c*, -*ç* etj.: *kadalan* (i ngadaltë), *keçan* (djalë ose burrë i

² A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, 1972, f. 154).

³ Po aty.

pahijshëm), *ngridhan* (i krekosur), *prishan* (nevrik), *pusan* (qyqar, i pazoti), *çuran* (hutaq), *rreban* (tekanjoz), *suran* (ai që i ka flokët e zbardhura), *xekrran* (nervoz, idhnak) etj.; *shkurtak* (shkurtabiq), *prehacak* – mendjemprehtë etj.; *fjalç* (fjalaman, që bart fjalë), *rrenc* (rrenacak); *bothç* (frikacak), *dhomç* (që është dhëmb të mëdhenj e çrregullt), *fryfç* (që lëvdohet shumë para të tjerëve, lëvdatëmadh), *flokç* (djalë me flokë të gjata), *hunç* (hundëmadh), *mrrolç* (i zymtë, i vrenjtur), *pritesç* (përtac), *kërkesçe* (femër që ka qejf të bredhë shumë, që kalon kohën duke shëtitur), *shtrydhç* (koprrac) etj.

Prandaj, mund të themi se ligjërimi popullor i trevës së Llapit ruan një thesar të pasur leksikor, që lidhet me jetën dhe mendësinë e banorëve të kësaj ane, mbledhja dhe botimi i të cilit është me interes të madh për leksikografinë tonë. Veçanërisht na del i pasur fjalësi me kuptim të figurshëm, me të cilin zgjerohet e pasurohet semantika leksikore e shqipes, sidomos në rrafshin e kuptimeve të prejardhura.

BIBLIOGRAFI

- Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1982.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, Grup autoresh
- Gramatika e gjuhës shqipe*, I, II, Tiranë, 2002.
- Larushia e fjalës në gojën e popullit*, Tiranë, 2013
- Lloshi, Xh., *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988.
- Memisha, V., *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.
- Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, III Tiranë, 1972, Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- Sula, A., *Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore*, Tiranë, 2009
- Shehu, H., *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe*, Tiranë, 2015,
- Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2000.
- Thomai, J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.
- Thomai, J., *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989.

